



# emathia

Botim periodik i Shoqatës Historike-Kulturore "Dilaver Kurti" Mat  
Viti i pestë i botimit Nr. 1 (17) - 2011 [www.revistaemathia.com](http://www.revistaemathia.com)

Çmimi 100 lekë



**ÇMIMET "PENDE BUDI"  
PËR VITIN 2010**



**TAKIM I INSTRUMENTISTËVE  
TË LAURISË**



**DËSHMORI SHAHIN TOÇI  
PREHET I QETË NË PANTEONIN E NDERIT**

## Ceremonia e rivarrimit të eshtrave të dëshmorit Shahin Toçi



SHAHIN TOÇI PREHET I QETË NË PANTEONIN E NDERIT Kujtim PORJA.....	1
KËNGË KUSHTUAR DËSHMORIT SHAHIN TOÇI F. BRAHIMI, G.J. BECI, Y. TOÇI.....	2
I FALEM VETËM FLAMURIT TIM Fatmir GJËSTILA.....	3-5
FAKTE DHE NGJARJE MBI KASTRIOTËT DHE HEROIN TONË KOMBËTAR Andrea LLUKANI.....	6-9
ZEJA E PUNIMIT TË BAROTIT NË KRAHINËN E MATIT Dilaver KURTU.....	10-15
PERIUDHA E DIFERENCIMIT FEUDAL NË LUGINËN E MATIT, SEMTET Ramiz FIÇORRI.....	16-17
LINOSI, NË NJË ROMAN MESJETAR FRANCEZ Gjokë DABAJ.....	18-19
MBISHKRIMET E LASHTË DHE RËNDËSIA E TYRE MA. Suzana KURTU.....	20-22
LUFTA E SHKALLËS SË DESHËVE PJESË E LAVDISHME E HISTORISË SË POPULLIT SHQIPTAR Hysni ÇUKA.....	23-25
GËSHTENJA, DRURI I BUKËS DHE I HISTORISË Prof. dr. Idriz XHOMARA.....	26-31
SHPËRNDAHEN ÇMIMET "PENDA BUDI 2010" Artan KURTU.....	31-35
SHKOLLA UNIKE E KLOSIT DHE FILLIMET E ARSIMIT SHTATËVJEÇAR NË MAT Aqif YMERI.....	36-38
KUADRI JURIDIK I SHTYPIT. KRAHASIMI MES MBRETËRISË SË ZOGUT I DHE DEMOKRACISË AKTUALE MA. Fatjon ÇUKA.....	39-42
KATUÇËT, PROTAGONISTË TË NJË HISTORIE TË TRILLUAR Hasan PASHA.....	43-46
NJ7 ÇIFTELI HESHT E VARUR NË MUR Sokol META.....	46-47
KRISTOFORIDHI I RILARTËSUAR NGA BUTË SHPIRTERORË Arlona MEMI.....	48-51
VARIETEJA E KRIPËS, poezi Fatmir ALIMANI.....	52-53
ERDHEN ÇUNAT PËR VITIN E RI, tregim humoristik Halit ÇITOZI.....	54-55
FLLADE DHE YLBERE, poezi Mevlud BUÇI.....	56-57
MALL NGA ZEMRA IME, poezi Ilir PËRLESI.....	57
JETA, IDEALI I NJERIUT, ese Suada STAFASANI.....	58
DUKE SODITUR NATYREN, ese Rigersa BUÇI.....	58
ADOLESHENCA, ese Geraldë RUÇI.....	59
A ËSHTE JETA NJË ENDËRR, APO AJO KA NJË ENDËRR? ese Dejon DEMIRI.....	59
TALENT NUK MUND TË BËHET KUSHDO Hamdi HYSUKA.....	60-61
NA BASHKOH LAURIA Dr. Fejzulla GJABRI.....	61-64

Përgatiti Artan KURTI, Rakip LASKU, Aqif YMERI,  
Basir BUSHKASHI, Hamdi HYSUKA

Arti grafik: Artan KURTI

[www.revistaemathia.com](http://www.revistaemathia.com)

Email: [revista.emathia@gmail.com](mailto:revista.emathia@gmail.com) Mobil: ++355 68 21 61 173

Sponsorizuar dhe shtypur nga

**ILAR**

# SHAHIN TOÇI PREHET I QETË NË PANTEONIN E NDERIT

Kujtim PORJA

**P**as 72 vitesh në dhë të huaj, eshtrat e Patriotit, Dëshmorit dhe Heroit të Nderit të Atdheut, oficerit të lartë të Mbretërisë Shqiptare, Shahin Toçit, kthehen në Shqipëri dhe tasimë janë vendosur në varrezat e dëshmorëve të rrethit të Matit.

Mesdita e 25 Marsit shënoi në aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza" të Tiranës, një ngjarje të rrallë. Nën tingujt e bandës frymore të Ministrisë së Mbrojtjes, në prani të ushtarakëve të lartë të kësaj ministrie e të trupës së nderit, të ambasadorit shqiptar në Romë Llesh Kola, të deputetëve të Qarkut Dibër në parlamentin shqiptar dhe të afërmeve e familjarëve të dëshmorit, zbret nga avioni i linjës arkivoli me eshtrat e martirit.

Ceremonia zyrtare e përcaktuar saktë nga zyra e protokollit e Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë vazhdoi me 26 Mars në hollin e Bashkisë së qytetit Burrel, ku u vendos arkivoli i Shahin Toçit, mbuluar me flamurin kombëtar. Pranë tij bënin roje nderi katër ushtarakë. Mbi njëmijë të pranishëm në ceremony. Në orën 10:00 nisën homazhet në nderim të veprës së dëshmorit. Morën pjesë ministri i mbrojtjes Arben Imami i shoqëruar nga ushtarakët dhe autoritetet më të larta të këtij dikasteri, kryebashkiaku i Bashkisë Burrel, Skënder Lleshi, deputetët e parlamentit shqiptar, Bedri Hoxha, Qemal Minxhozi e Fatmir Toçi, përfaqësuesja e Presidentit të Republikës, përfaqësuesi i Familjes Mbretërore, Princ Leka, delegacioni nga vendi mik, Italia, që mbajti në gjirin e saj për 72 vite eshtrat e birit të Matit, përfaqësues të shoqatës së të Përmjekurve Politikë të Shqipërisë, të afërm e miq të familjes dhe qytetarë të qytetit të Burrelit e rajonit të Matit.

Rreth orës 11:00 arkivoli i akademikut ushtarak Shahin Toçi, mbi supet e ushtarakëve dhe shoqëruar nga truproja e nderit e ceremonialit ushtarak, vijoi udhëtimin e tij të fundit për në varrezat e dëshmorëve. Gjatë gjithë rrugës kortezhi u shoqërua nga banda frymore dhe qindra qytetarë e personalitete. Në orën 11:30 nën tingujt e Himnit Kombëtar Shqiptar



dhe qitjet e armëve të ushtarakëve, arkivoli i mbuluar nga flamuri kombëtar zbriti përjetësisht në banesën e fundit. Personalitete të shtetit shqiptar: Ministri i Mbrojtjes, Arben Imami, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Gjeneral-Major Maksim Malaj, kryetari i Bashkisë Burrel Skënder Lleshi, deputetët Bedri Hoxha, Qemal Minxhozi, Fatmir Toçi, përfaqësuesja dhe e dërguara e Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bamir Topi, shoqatat e veteranëve si dhe familja e dëshmorit vendosën kurora me lule mbi varrin e tij. Me tej ceremonia vazhdoi në sallën e madhe të Qendrës Kulturore Burrel, nën tingujt e Himnit Kombëtar, ku folën shumë autoritete mbi jetën dhe veprën patriotike të oficerit patriot Shahin Toçi. Midis të tjerave, Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, theksoi: "Vepra e Shahin Toçit, i cili kundërshtoi betimin ushtarak përpara flamurit fashist, është një gjest i lartë patriotik e atdhetar për të cilin pagoi me jetën e tij. Vepra e tij duhet të frymëzojë sot ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë."

Shahin Toçi është shembull nderi për të gjithë ata burra trima nga Drenica, malet e Shkodrës dhe Tropojës, Dibra e Mati, Kolonja burrërore, Labëria trime dhe Çamëria martire. Shahin Toçi është shembull nderi jo vetëm

për vendlindjen e tij, Matin por për gjithë Shqipërinë. Ne dhe historia i mbetemi borxhli patriotizmit dhe shqiptarizmit të tij".

Kryebashkiaku Skënder Lleshi, theksoi se kthimi i eshtrave të Shahin Toçit në atdhe dhe vendosja e tyre në panteonin e nderit, është pjesë e vlerësimit të veprës së tij patriotike. Ne emër të Familjes Mbretërore lexoi përshëndetjen e dërguar nga Mbreti Leka Zogu I, kryetari PLL Mat, Agim Selita.

Në emër të grupit Italian, që mori pjesë në ceremoni, foli inxhinieri Dario Bonano, i cili ka ndihmuar në gjetjen e eshtrave të dëshmorit.

Ai vlerësoi përkushtimin dhe vendosmërinë e nipit të dëshmorit (Shahin Toçi i Ri, djali i vëllait të dëshmorit Shahin Toçi) i cili për 18 vite nuk reshti përpjekjet për gjetjen e eshtrave të xhaxhait të tij, përpjekje të cilën e finalizoi me sukses sot pas 72 viteve. Nipi i patriotit Shahin Toçi, foli në emër të familjes, ku theksoi se në përpjekjet e tij 18 vjeçare për gjetjen dhe kthimin e eshtrave të xhaxhait të tij në atdhe ka qenë i obliguar nga amaneti i të parëve të tij, por, edhe nga detyra atdhetare që një patriot e personaliteti si Shahin Toçi t'i kthehej atdheut të tij Shqipërisë. Ai falenderoi ministrin e mbrojtjes, ambasadorin shqiptar në Itali dhe të gjithë ata që ndihmuan në kurorezimin me sukses të kësaj ndërmarrjeje të vështirë.

Në emër të Presidentit të Republikës Bamir Topi, e dërguara e tij i dorëzoi familjes Medaljen e Artë të Shqiponjës, akorduar ushtarakut patriot Shahin Toçi. Një buqetë këngësh kushtuar dëshmorit Shahin Toçi u interpretuan nga këngëtari popullor Shkëlqim Farrici, grupi i burrave të Mirditës dhe, si aureolë, kënga e grupit polifonik lab të Vlorës. Më pas u shfaq një film i ri dokumentar prodhim i TV Shqiptar, kushtuar jetës dhe veprës së Shahin Toçit.

Në fund familja shtroi një koktejl për nder të pjesëmarrësve në ceremoni.

# I FALEM VETËM FLAMURIT TIM

Fatmir GJESTILA

Romë, 25 maj 1939. Në orët e para të mëngjesit, në një bujtinë, rruga Trans - Tevere nr. 45 gjendet i vrarë oficeri shqiptar Shahin Osman Toçi. Studentët dhe ushtarakët shqiptarë, që studionin në Romë nuk u lejuan të shikonin trupin e pajetë të bashkatdhetarit të tyre dhe as të merrnin pjesë në varrimin e tij. Varrimi u krye në mënyrë të fshehtë. Lajmin e kësaj vrasje e transmetuan edhe disa nga radiot e shteteve perëndimore, duke e komentuar si vrasje politike.

Përse dhe nga kush u vra Shahin Toçi? Përse u varros tinëzisht dhe me ç'qëllim u bënë përpjekje nga policia sekrete fashiste që rrethanat e kësaj vrasjeje të mbulohej me mister?

Shahin Osman Toçi u lind më 14 prill 1914 në një familje me tradita patriotike në Urxallë të rrethit të Matit. Mësimet e para i mori në Derjan të Matit dhe më pas, për arritje cilësore në mësimet i jepet e drejta e studimit në Shkollën Mbretërore Ushtarake në Tiranë. Pas përfundimit të studimeve në këtë shkollë, nisët për studime jashtë vendit, pasi kishte fituar konkurrimin para një jurie ushtarake të specializuar. Në tetor të vitit 1934 rregjistrohet në Kolegjin Ushtarak të Napolit dhe studimet i përfundoi në korrik të vitit 1937.

Në bazë të përzgjedhjes së bërë nga sektori ushtarak për arsimimin e mëtejshëm të studentëve, në tetor të vitit 1937 Shahin Toçit iu dha e drejta për kryerjen e studimeve në Akademinë e Këmbësorisë dhe Kavalerisë në Modena. Pas përfundimit me sukses të vitit akademik 1937-1938, diplomohet në Akademinë e Këmbësorisë dhe Kavalerisë së Modenas. I vlerësuar si një ndër studentët më të përgatitur ndër vite, në verën e vitit 1938, thirret në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtu punon vetëm disa javë. Autoritetet ushtarake shqiptare do ta veçonin mes shumë oficerëve të tjerë për të kryer specializimin njëvjeçar pasakademik në Romë. Kjo përzgjedhje nuk ishte rastësi: te Shahin Toçi dalloheshin jo



vetëm aftësitë ushtarake, por dhe kulturimi i gjithanshëm, cilësitë morale, patriotike, këndvështimet e qarta e të mprehta të periudhës, që po kalonin marrëdhëniet e shtetit shqiptar me Italinë fqinje, por dhe ato ndërkombëtare. Gjatë viteve të studimit në Itali arrin të përvetësojë në një shkallë të lartë gjuhën italiane dhe të njohë mirë atë franceze. Zotërimi i këtyre gjuhëve i mundësuan leximin dhe të studimin në origjinal të literaturës plotësuese ushtarake, historike, gjeografike, filozofike dhe letërsisë botërore.

Në tetor të vitit 1938 Shahin Toçi vendoset në Romë dhe nis specializimin ushtarak njëvjeçar pasakademik.

Pas pushtimit fashist të Shqipërisë, në ditët që vijuan, te shumë studentë dhe oficerë shqiptarë në shkollat italiane nisi të kristalizohej ideja për t'u organizuar e për të kapërcyer Adriatikun. Grupi organizator i kundërshtimit të pushtimit kërkonte që qëndrimet kundërshtuese të ishin të hapura dhe të drejtpërdrejta. Në një nga këto takime, Shahin Toçi, organizatori më i spikatur, theksonte me forcë: "Këta, (fashistët, sh.a.) në emër të qytetërimit të tyre, lajkatojnë me fjalë të bukura për të justifikuar grabitjen e lirisë së

popujve. S'ka mbetur rrugë tjetër veçse të kthehemi në atdhe e të rrokim armët." Ndërsa përgjigja e tij ndaj disa shërbëtorëve të fashizmit, të lëkundurve dhe frikacakëve, që mbanin në gojë parullën "Kush prek fashizmin prek vdekjen", ishte: "Të vdesësh një herë dhe i ndershëm është më shumë se të lindësh njëmijë herë dhe tradhëtar".

Fashistët, të cilët, përmes agjentëve të tyre survejonin veprimtarinë e studentëve dhe oficerëve shqiptarë, kishin arritur të evidentonin me kohë Shahin Toçin si organizatorin kryesor. Autoritetet italiane nisën të organizonin veprimtari të shumta, që kishin për qëllim zbehjen e revoltës, që po ziente mes oficerëve dhe studentëve shqiptarë si dhe bindjen e tyre për t'i kthyer në kontigjente të fashizmit. Me fillimin e muajit maj, autoritetet drejtuese të shkollave ushtarake shpалosën para studentëve fillimin e përgatitjeve për betimin para flamurit fashist. Me një qëllim tejet të paracaktuar, kjo veprimtari ishte planifikuar me ngut nga qeveria dhe Ministria e Luftës italiane, që me zbarkimin e trupave fashiste në Shqipëri. Përmes elementëve mbështetës të tyre në Shqipëri fashistët kishin nisur një propogandë të ethshme me familjet e ushtarakëve shqiptarë që studionin në Itali. Këta elementë kërkonin nga këto familje që të ndikonin tek djemtë e tyre për të mos e kundërshtuar betimin, duke e paraqitur pushtimin real të Shqipërisë si përpjekje për drejtësi dhe zhvillim të gjithanshëm të saj. Këtyre shërbëtorëve të fashizmit babai i Shahinit Toçit iu është përgjigjur duke thënë: "Im bir i njeh fort mirë ngjyrat e flamurit të Shqipërisë dhe kufijtë e saj."

Falë veprimtarisë patriotike të oficerëve dhe studentëve më aktivë, kundërshtarë të deklaruar të pushtimit fashist, studentët shqiptarë e kuptuan se autoritet italiane, me anën e kësaj veprimtarie, kërkonin t'i bënin palë në pushtimin e atdheut të tyre.

# KËNGË KUSHTUAR DËSHMORIT SHAHIN TOÇI

SHAHIN TOÇI,

NDERI YNË

Feti BRAHIMI,  
rapsod vlonjat

Po ta dija çiftelinë  
unë e di sa do këndoja.  
Gjithë forcën e shpirtit tim  
heroi do t'ia dhuroja.

Kur lexova historinë,  
një libër të madh shfletova,  
e zgjodha mirë poezinë,  
Shahin Toçit ia kushtova.

Veprat lartësojnë njerinë,  
i kthejnë trimat në shqiponja,  
bëhen flamur për larine,  
i nderojnë qindra miliona.

Akademist Shahin!  
Ku je more burrë? -i fola.  
Një shekull larg në megrim,  
sot erdhe me këngët tonë.

Sot erdhe me flamurin,  
tutje, larg mbeti Roma.  
Matë pretë birin e tij,  
me nderim të pret dhe vlorë.

Dëgjo polifoninë,  
si flaka që shpërthen nga goja.  
Flaka që ka ndalë stuhinë  
sa herë që ka dasht nevoja.

Shahin Toçi nderi ynë,  
të ka bukuri kurora.  
Kush fal jetën për Shqipërinë  
mbetet monument në kohëra.

Ti s'pranove tradhëtinë,  
flamuri s'të ra nga dora.  
Ballë për ballë me këmishëzinj  
ti mbi ta ia bëre fora.

Malet rreth e rreth po rrijnë,  
në Urzallë ndihet jehona.  
Në Dejë bora po shkrin,  
po rriten lulët e njoma.

Prehu i qetë në lëndinë,  
në mes lulesh me aroma!  
Ti Shahin, mbete nderim,  
mbete flamurtar me prova.

Vlorë, 2011

JAM SHQIPTAR,

GJAK ILIRIANI

Gjokë BECI,  
poet mirditor

Flet Urxalla n'krahinë të Matit,  
Flet shqiponja n'lisa të shpatit:  
-Kush shqiptar vetes po i thotë  
Si n'Arbni, Europë e botë  
Kur Flamurin ta shikojë,  
Shahin Toçin ta nderojë!

Leu si rrezja n'ato shkrepë  
Ku fillon trimnia n'djepa  
Rreth një sofërë atdhetare  
Mori flakë një ndjenjë krenare.  
N'atë Modena të Italisë  
Ngjiti shkallët e akademisë...

Në muajin maj tridhjetë e nandë  
Në shpirt na i ra një gjamë e randë;  
Urdhni i zi po i turret trimit,  
Me u betue në flamur t'pushtimit,  
Prej rreshtimit shigjetë doli  
Në uniform shqiptare foli:

Me kadalë, zotni Pariani,  
Jam shqiptar, gjak iliriani,  
Në majë të qiellit e n'zemër të dheut  
Rron flamuri i Skënderbeut;  
Kudo t'jem besën s'ja luj,  
Dal prej vorrit e i bie në gjunjë...

Jam matjan, jam rracë krenare  
Më ka dhanë jetë një nanë shqiptare;  
Ku del shqipja e flet me gurin  
Qoftë mallkue kush ndërron flamurin!  
Por tradhëtia ja merr jetën  
Me pesë plumba, në gjumë tuj fjetun...

Tash po t'pyes, moj zanë Urxalle,  
Pse t'kanë thanë legjendë shqiptare?  
Se mbi shkamb ku prita dritën  
Shahin Toçin e kam rritun,  
Ja kam falë flamurit t'vetëm  
Sa të jetë jeta mos me vdekun.

Tiranë, 2005



Ymer TOÇI,  
Rapsod matjan

KËNGË PËR SHAHIN TOÇIN

Kjo Shqypni ka rritun burra  
që nuk njofi'n-o dy fllura,  
ua ka thanë nana në gjep,  
për Shqypnin' djali me vdek  
e në qoftë-o para litarit,  
nxjerr barut-o goj' e shqyptarit.

Historinë për me ua thanë,  
në mujn maj-o tridhjetë e nantë,  
foli radia jashtë e mrena  
se studentat-o në Modena,  
këto studentat e Shqypnisë,  
në mes t'Romës-o t'Italisë,  
mu në sheshin para betimit  
i thanë Duçës-o, Musolinit:  
-Jem' besnik-o vetëm t'atdheut  
e t'flamurit-o t'Skënerbeut.

Shahin Toçi një matnjan,  
gjenerailt-o na i kish' thanë:  
-Kjo Shqypni ne na ka rritun,  
kurrë prej nesh-o nuk ka me u shitun.  
kush ta shkeli le t'menohet,  
se shqyptari-o nuk nënshtrohet.

Por agjentat kanë vendosun  
jetën trimit-o me ja sosun,  
e kan' vra-o me marifet,  
mrapa shpine, në gjumë tuj fjet.  
Rri i qetë mor djalosh i ri,  
për flmurin u bane fli,  
vllaznit e tu ta kanë marrë hakun,  
këmishëzezët e pagun' gjakun.  
Urxallë, 1969



e atdheut tim", është përgjigjur Shahin Toçi. Ironik dhe me zemëratë gjenerali fashist ka spherthyer: "C'lehtë ka ajo uniforme? Mbreti juaj ka rënë, tani ju kemi fatin të mbani një uniformë të madhe, atë të Mbretërisë Italiane." Oficerit shqiptar i është përgjigjur flakë për flakë: "Gabohehi, zoti gjeneral! Mbretërit edhe mund të bien, po atdheu mbetet po ai, flamuri nuk ndërrohet" dhe, duke u këthyer nga bashkatdhetarët e tij ka ngritur edhe më shumë zërin duke folur shqip: "Bashkatdhetarë! Në i bëmë në gjuhë vetëm flamurit tonë! Mjerë kush e ndërton flamurin dhe tradhëton Shqipërinë."

Edhe pse mjaft i nervozuar, gjenerali fashist ka ruajtur qetësinë dhe është përpjekur që, përmes një fjalimi të shkurtër demagogjik të qetësojë revoltën.

Me pas do të ndiqej një taktikë tjetër, pas leximit të betimit oficerët e studentët do ta konfirmimin atë duke u përgjigjur: Betohehi! Por edhe pas kësaj përpjekjeje ushtarakë shqiptarë kanë heshitur. Kur është kërkuar arsyeja e kësaj heshije, ka qënë përsëri Shahin Toçi që ka protestuar: "Ne betohehi vetëm në gjuhë shqipe! Shqip dhe për flamurin shqiptar! Vetëm atij i falemi." Rrështat janë shpërndarë dhe kësaj ceremonie ka dështuar në prani të autoriteteve të larta italiane, të diplomateve dhe gazetarëve.

Me pas, disa ushtarakë shqiptarë u izoluan e të tjerë u burgosën, ndërsa shërbimet sekrete dhe agjentët e SIM-it organizuan eliminimin fizik të Shahin Toçit, tek i cili shikonin organizatorin dhe frymëzuesin kryesor të revoltës kundër tyre.

Shahin Toçi u ekzekutua në mesnatën e 24 majit të vitit 1939. Në mëngjesin e 25 majit, studentët shqiptarë, të grupuar në rrugën Trans-Tevere nr. 45,

Në një nga ditët e dhjetëditëshit të fundit të muajit maj u organizua një ceremoni-provë. Pjesëmarrja në këtë ceremoni e nënsekretarit të shtetit italian për luftën, tregonte jo vetëm rëndësinë që i jepnin fashistët kësaj ceremonie, por dhe qëllimin e saj testues në lidhje me studentët dhe ushtarakët shqiptarë. Sipas dëshmive të disa prej studentëve dhe oficerëve shqiptarë, pjesëmarrës në këtë ceremoni, kur prova po fillonte, Shahin Toçi del nga rreshti dhe pozicionohet përballë autoriteteve ushtarake. Cfarë tërhoqi vëmendjen e gjeneralit fashist nuk ishte vetëm lëvizja e oficerit shqiptar, por dhe uniforma e tij: Shahin Toçi ishte veshur me uniformë shqiptare mbi të cilën kishte hedhur një shirit kuq e zi. "Po ju?! C'është kjo uniformë?", ka ngritur zërin gjenerali fashist. "Unë jam shqiptar, zoti gjeneral dhe kjo është uniforma ushtarake



kërkuan trupin e bashkatdhetarit dhe frymëzuesit të tyre për ta këthyer në atdhe, por kjo kërkesë si edhe tjetra: për ta shoqëruar në varreza, nuk u pranua. Trupi i pajetë i oficerit shqiptar u varros në mënyrë të fshehtë, por jehona e qëndrimit të tij patriotik u përcoll edhe nga radiot e disa shteteve perëndimore të cilat e cilësuan eliminimin e tij si vrasje politike.

Pas disa javësh, autoritetet italiane sollën në Shqipëri sendet personale të Shahinit, ku pjesën më të madhe e zinin librat. Gjatë dorëzimit të këtyre sendeve, njëri nga oficerët italianë i paraqet Osman Toçit, babait të Shahinit, disa formulae, të cilët pasi të plotësoheshin duhej të dorëgoheshin në Itali për lidhjen e një pensioni. Osman Toçi ka refuzuar duke thënë: "Ne nuk e shesim gjakun, ia falim veç flamurit!"

Pas çlirimit të vendit nga nazi-fashistët, në luftën ndaj të cilëve mori pjesë edhe vëllai i Shahinit, Dyle Toçi, familja Toçi dhe të afermit e saj kanë kërkuar vazhdimisht nga shteti shqiptar që të sillleshin në atdhe eshtrat e birit të tyre, të dalloshit trim, që lartësoi ndjenjën e krenarisë kombëtare në darën fashiste. Por edhe pas shpalljes së Shahin Toçit Dëshmor i Atdheut, shteti shqiptar nuk u interesua të sillte eshtrat e tij, në një kohë që eshtrat e ushtarëve pushtues u morën nga qeveria italiane.

Pas vitit 1990, nipërit e dëshmorit, rritën me shpresa të reja përpjekjet këmbëngulëse të prindërve të tyre.

Në vitin 1993 Shahin Islam Toçi vendoset në Romë dhe Osman Islam Toçi në Tiranë për t'u udhëhequr në jetën e tyre nga i vetmi qëllim: sjellja në atdhe e eshtrave të shaxhait të tyre, flamurtarit të kombit. Vëllat i dëshmorit, Islam Toçi, nuk rronte më, por dy djemtë e tij, Shahini e Osmani, përveçse forcën e amantetit, kishin përkrah nënën e tyre, Dushen, një grua sojnikë, që kishte ruajtur me aq kujdes

dëshuri reliket dhe librat e dëshmorit, për të cilin fliste me krenari e adhurim të patreguar. Këmbëngulja dhe autoritetet e administratës së varrezave në Verano të Romës, të cilët në shenjë respekti dhe humanizmi të larta shtetërore shqiptare, duke shoqëruar ardhjen e eshtrave të dëshmorit në atdhe dhe rvarrimin e tyre gjatë një ceremonie madhështore. Padyshim, përveçse plotësimin amanetin e të parëve, Shahin I. Toçi dhe Osman I. Toçi, këta djem kurajozë e atdhetarë, sollën në atdhe Shahin Toçin, i cili ngriti lart flamurin e kombit në ditë më të vështira të tij, duke na kujtuar me krenari se ngjyrt e flamurit janë të shenjtë e të pajetërsueshme.

Akti i lartë heroik i Shahin Toçit do t'ju kujtojë brezave se kush bie për flamur i bën nderin më të lartë kombit e kësaj mbetet në palet e flamurit dhe fluturimin e lirë të shqipes.



Rast i rralle

# DËSHMORI SHAHIN TOÇI PAS 72 VJETËSH U KTHYE NË ATDHE

Po vjen

Po vjen. Pas 72 vjetësh. Iku sa një mal, djalë i ri dhe u kthye i tretur, në një kuti arkivoli, mbuluar me Flamur. E kërkonte toka e vet, vendlindja e vet.

Po vjen. Nuk e mbante toka e huaj, dheu i huaj, se për atë vend ishte një trup i huaj, që e flakte tej, si një organizëm i gjallë, që nuk e pranon një organizëm të huaj. Për 72 vjet u tret, por nuk gjeti qetësi. Për asnjë moment.

Po vjen. U duk aeroplani në qiellin e kaltërt, si një pëllumb i bardhë, që sa vinte zmadhohej. Emocionet po na shtoheshin, zemra po na rrihte me rrëmbim.

Po vjen. Avioni, mori një rrotullim dhe iu drejtua pistës, me shugullimë të madhe. Mu duk se u dridh toka, kur rrota e tij takoi në pistë. Mbante një peshë të rëndë. Sigurisht që mbante një peshë të rëndë, si plumb, jo në kuptimin fizik, por moral. Ishte një arkivol i vogël, që mbante brenda një dëshmor të atdheut, i cili takoi tokën e vet. Dhe ajo e ndjeu birin e saj, që i mungonte, erdhi e do ta fuste në gji.

Erdhi. Shkallët lëvizëve u afruan te portat e avionit BeleAjr. Përballë u reshtua roja e nderit, Garda e Republikës. Katër gardistë, djem trupgjatë, të bukur e të shëndetshëm, me uniformën e kuqe me nuancë portokalli, u ngjitën shkallëve dhe nxorrën nga barku i avionit arkivolin e mbuluar me Flamurin Kombëtar. E zbritën me kujdes nga shkallët, pastaj e ngritën mbi supe dhe parakaluan trupojën e nderit, nën tingujt e orkestrës frymore të ushtrisë dhe u drejtuan drejt daljes nga aeroporti, ku priste publiku.

Kishin ardhur nipër, mbesa, breza të fisit të Shahin Toçi, shokë e miq të shumtë të këtij fisi nga të katër anët e Shqipërisë, si dhe shumë qytetarë të tjerë. Të gjithë u rreshtuan nga të dya anët e rrugës, në dalje të aeroportit, me flamuj e tufa lulësh në duar.



Arkivolin e mbanin katër gardistë, të shoqëruar nga trupa e gardës, që prihej nga një gardist me portretin e Shahin Toçit në duar. Orkestra frymore, duke ekzekutuar marshe funebër printe në krye. Në fund të kortezhit shoqëronin disa nga familjarët më të afërt, si dhe personalitete zyrtare. Binte në sy deputeti Fatmir Toçi, me bashkshorten e tij, nga Kuçi i Vlorës, i cili qenkësh me origjinë të herëshme nga fisi Toçi, fshati Urxallë i rrethit të Matit.

Pas kësaj ceremonie prekëse, nipat e dëshmorit Shahin Toçi shtruan një koktej në një nga lokalet e aeroportit, ku u bënë përshëndetje nga deputeti Fatmir Toçi, ambasadori i Shqipërisë në Rome, z. Llesh Kola etj. Në emër të kryesisë së Organizatës Kombëtare për Dëshmorët e Atdheut, pershendeti edhe autori i ketij reportazhi. Më pas nipërit pritën vizita edhe në shtëpinë e tyre në Tiranë.

Të nesërmen, më 26 mars në qytetin e Burrelit u organizua një ceremoni madhështore kushtuar varrosjes së eshtrave të dëshmorit Shahin Toçi. Në

fillim u bënë homazhe pranë arkivolit të tij, në hollin e Bashkisë së Burrelit, ku morën pjesë Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, deputetët Fatmir Toçi e Qemal Minxhozi, si dhe shumë përfaqësues subjektsh ploitike e shoqërore dhe intelektualë të njohur. Vargu i gjatë i pjesëmarrësve jo vetëm nga Burreli e fshatrat, por edhe nga rrethe të tjera si: Vloza, Prizreni, Tirana, Kruja, Kurbin, Mirdita, Dibra, Lezha etj., i dha kësaj ceremonie një pamje masiviteti, të paparë ndonjëherë në këtë qytet.

E gjithë kjo masë e madhe njerëzish e shoqruan kortezhin të varrezat e dëshmorëve, duke i rënë mes për mes bulevardit, nën tingujt e marsheve funebër të orkestrës frymore të ushtrisë. Zbritja e arkivolit në shtratin e varrit, u shoqërua me të shtëna artilerie dhe pastaj me ekzekutimin e himnit të Flamurit e parakalimin e trupojës së nderit para varrit të tij të mbuluar me një mal kurora e buqetash me lule nga autoritetet dhe familjarët.

Shahin Toçi u varros përjetësisht përkrash shokëve të vet, dëshmorë të Atdheut, duke shtuar edhe një emër tjetër lavdie në këto varreza.

Pas varrimit Bashkia e Burrelit organizoi një mbledhje solemne, kushtuar dëshmorit Shahin Toçi. Fjalën e rastit e mbajti kryetari i Bashkisë Skënder Lleshi. Folën në këtë ceremoni Kryetari i veteranëve të rrethit, përfaqësuesi i shtetit Italian dhe nipi i dëshmorit.

Mbledhja solemne u përcoll me një program shumë të pasur artistik, nga grupet artistike të Burrelit, të Mirditës e të Vlorës. Me entuziazëm e brohoritje të përsërituara e të papërshkrueshme u përcoll kënga polifonike e grupit të Vlorës, kushtuar dëshmorit Shahin Toçi.

Kështu i përjetëson populli ynë dëshmorët e Atdheut.

Organizata Kombëtare për Dëshmorëte e Atdheut, u shprehë falenderime të veçanta nipërve të dëshmorit Shahin Toçi, Shahin Toçi të Ri dhe Osman Toçi, të dy djemtë e Islamit, vëllait të Shahinit, të cilët me përkushtim të rrallë, me shpenzime të mëdha, bënë të mundur gjetjen e varrit të Shahinit dhe mundësuan sjelljen e eshtrave të tij në Atdhe, duke organizuar me shpenzimet e tyre edhe këtë ceremoni madhështore.

Lum si ai, që le prapa brezni të tillë, siç ka lënë dëshmori Shahin Toçi.


**Halil Katana- Bardhok Arapi**  
Rinas -Burrel, 25-26 mars 2011

## Rrethanat e vrasjes


Një vrasje e shëmtuar tronditi më 26 maj të vitit 1939 rrugën "Trastevere" në Romë. Një i ri shqiptar, me emrin Shahin Toçi, i sapodiplomuar në Akedeminë Ushtarake, u gjend i vdekur nga autoritetet italiane. Shumë hipoteza do të hidheshin për shkakun e vdekjes, shumë pikëpyetje qëndronin rreth shkakut të saj, por e vërteta mbeti e pazbuluar. Shteti italian arkivoi dosjen Toçi, ndoshta për të fshehur atë që kishte ndodhur realisht e që kishte lidhje me aktin e madh patriotik të këtij shqiptari nga Mati.

Dy javë para se të gjendej i vvarë, Shahin Toçi kreu një gjest i cili, në distancën e 70 vjetëve, rrezaton patriotizëm dhe burrëri të spikatur. Është pikërisht ai qëndrim i fortë prej shqiptari patriot, i cili ndoshta i kushtoi jetën, në mesin e një Italie të pushtuar nga ethet e fasiszmit dhe të dominuar nga këmishat e zeza. Megjithatë, para se të komentojmë vdekjen e tij, le të shohim cili qe dhe çfarë përfaqësonte ky djalosh 21 vjeçar.

I lindur më 30 tetor 1918, Shahin do të shquhej shpejt për cilësitë e tij. Jeta e Shahin Toçit, peripecitë e studimeve në Itaal dhe, përgjithësisht, ekzistenca e tij në pjesën e fundit të jetës, kanë qenë një dramë e vërtetë, e cila zhvillohej larg atdheut dhe që përfshinte dinamikën e ngjarjeve të trubullta për Shqipërinë, në vitin 1939... Në debatet mes studentëve shqiptarë, veçanërisht të ndezura në ato momente, ai tregoi gjithnjë i



Shahin Islam Toçi (nipi)



Osman Islam Toçi (nipi)

kujdesshëm, për të mos u lënë vend interpretimeve të lehta e sipërfaqësore. Ishte i bindur se mes propagandës fashiste dhe në një largësi aq të madhe nga vendi, ngjarjet, faktet dhe e vërteta e pushtimit vinin të shtrembëruara, emotive dhe subjektive. Megjithatë Shahini qe ndër të parët që hodhën idenë e organizimit të studentëve për t'u kthyer në Shqipëri e për të luftuar për çlirimin e vendit. "Këta që flasin me fjalë të bukura dhe që e mbajnë vetëm të qytetëruar, në fakt justifikojnë robërinë e popujve", - shprehej ato ditë Shahin Toçi. "S'ka mbetur rrugë tjetër, veçse të hedhim armët dhe rrobën fashiste e të kthehemi në atdheun tonë. Atje s'ka humbur besa, as burrëria. Atje mund të organizohemi edhe më mirë, për të hedhur tutje robërinë". Me këto fjalë në gojë, ai debatonte pa pushim me studentët e tjerë, të cilët u bindeshin pa shumë rezistencë ideve fashiste.

Shahin Toçi do të shihte gjithë dëshprim momentin kur kurora mbretrore shqiptare do të dorëzohej në Romë nga garda kombëtare, çka do të përjetohej nga ai si një tragjedi e brendshme. Megjithatë, Shahin Toçi diti të qëndrojë si një shqiptar i fortë edhe në ato ditë të vështira, edhe larg vendit të tij.

Me fillimin e majit 1939, studentët shqiptarë në Akedeminë Ushtarake, i mbledhin në një sallë të madhe, për të bërë betimin. Komandanti i

Akademisë, si u foli studentëve për lidhjet e reja mes Italisë dhe Shqipërisë, i ftoi ata që të bënin betimin fashist, ku angazhoheshin se do të ishin në shërbim të plotë të Romës. Sipas programit, betimi do të bëhej në një nga sheshet e kryeqytetit italian, në datën 13 maj 1939.

Ditën e betimit, në një ceremoni të blinduar nga trupat italiane, ku merre pjesë dhe nënsekretari i i luftës Pariani, studenti shqiptar Shahin Toçi u paraqit me një shirit të kuq e zi, mbi uniformën ushtarake italiane. Ky simbol krijoi përshtjellim të dukshëm te oficerët e lartë, që ishin prezent në ceremoni, të cilët i kërkuan të riut nga Shqipëria të hiqte menjëherë shiritin kuq e zi. Ishte general Pariani, ai që u habit më shumë nga ky gjest: "Ç'vlerë ka kjo uniformë, mbreti juaj ka rënë", - iu drejtua ai Toçit. "Edhe mbretërit mund të bien, edhe uniformat mund të ndërrohen, por ky shirit mbetet", - iu përgjigj Shahin Toçi. Dëshmitarët e atij momenti tensioni thonë se gjenerali Italian heshti pas replikës së të riut. Në të kundërt, studentëve shqiptarë iu kërkua që të nesërmen të rreshtoheshin serish, për të recituar formulën e betimit fashist. Kur oficeri nisi të lexonte me zë të lartë tekstin, ajo që pasoi, ishte një heshtje e thellë. U kujtua se studentët nuk kuptonin shqip, por në atë çast Shahin Toçi doli nga reshti dhe foli me zë të lartë: "Zoti gjeneral, ne jemi shqiptarë dhe



# DËSHMORI SHAHIN TOÇI PAS 72 VJETËSH U KTHYE NË ATDHE

Po vjen

Po vjen. Pas 72 vjetësh. Iku sa një mal, djatë i n' dhe u kthye i tretur, në një kuti arkivoli, mbuluar me flamur. E kërkonle toka e vet, vendin e vet.

Po vjen. Nuk e mbante toka e huaj, dhe i huaj, se për atë vend ishte një trup i huaj, që e flakte tej, si një organizëm i gjallë, që nuk e pranon një organizëm të huaj. Për 72 vjet u tret, por nuk gjeti qetësi. Për asnjë moment.

Po vjen. U duk aeroporti në qelin e kaltërt, si një pëllumb i bardhë, që sa vinte zmadhohej. Emocionet po na shtoheshin, zemra po na nrite me njëmbim.

Po vjen. Avioni, mori një rotullim dhe u drejtua pistës, me shugullimë të madhe. Mu duk se u drith toka, kur rota e tij takoi në pistë. Mbante një peshë të rëndë. Sigurisht që mbante një peshë të rëndë, si plumb, jo në kupimin fizik, por moral. Ishte një arkivol i vogël, që mbante brenda një dëshmor të atdheut, i cili takoi tokën e vet. Dhe ajo e ndjeu binin e saj, që i mungonte, erdhi e do ta fuste në gj.

Erdhi. Shkallët lëvizëve u afruan te portat e avionit BeleAjr. Përbalë u rreshtua roja e nderit, Garda e Republikës. Katër gardistë, djem trupgjatë, të bukur e të shëndetshëm, me uniformën e kuqe me nuancë portokalli, u ngritën shkallëve dhe nxorën nga barku i avionit arkivolin e mbuluar me flamurin Kombëtar. E zbritën me kujdes nga shkallët, pastaj e ngritën mbi supet dhe parakaluan truporin e nderit, nën tingujt e orkestrës frymore të ushtrisë dhe u drejtuan drejt daljes nga aeroporti, ku prishte publiku.

Keshin ardhur nipër, mbesa, breza të fisit të Shahin Toçit, shokë e miq të shumtë të këtij fisi nga të katër anët e Shqipërisë, si dhe shumë qytetarë të tjerë. Të gjithë u rreshtuan nga të dyja anët e rrugës, në dalje të aeroportit, me flamuj e tufa lulësh në duar.



Arkivoli e mbanin katër gardistë, të shoqëruar nga trupa e gardiës, që prihej nga një gardist me portretin e Shahin Toçit në duar. Orkestra frymore, duke ekzekutuar marshe funebër printe në krye. Në fund të kortezhit shoqëronin disa nga familjarët më të afërt, si dhe personalitete zyrtare. Binë në sy deputeti Fatmir Toçi, me bashkshorten e tij, nga Kuçi i Vlorës, i cili qenkesh me origjinë të herëshme nga fisi Toçi, fshati Unxallë i rrethit të Matit.

Pas kësaj ceremonie prekëse, nipat e dëshmorit Shahin Toçi shtruan një koktej në një nga lokalët e aeroportit, ku u bënin përshëndelje nga deputeti Fatmir Toçi, ambasadori i Shqipërisë në Romë, z. Llesh Kola etj. Në emër të kryesisë së Organizatës Kombëtare për Dëshmorët e Atdheut, pershendeti edhe autori i këtij reportazhi. Më pas nipënt pritiën vizita edhe në shtëpinë e tyre në Tiranë.

Të nesërmen, më 26 mars në qytetin e Burrelit u organizua një ceremoni madhështore kushtuar varrosjes së eshtrave të dëshmorit Shahin Toçi. Në

fillim u bënë homazhe pranë arkivolit të tij, në hollin e Bashkisë së Burrelit, ku morën pjesë Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, deputetët Fatmir Toçi e Qemal Minxhozi, si dhe shumë përfaqësues subjektsh politike e shoqërore dhe intelektualë të njohur. Vargu i gjatë i pjesëmarrësve jo vetëm nga Burreli e fshatrat, por edhe nga rrethet e tjera si: Vloja, Prizreni, Tiranë, Kruja, Kurbini, Mirdita, Dibra, Lezha etj., i dha kësaj ceremonie një pamje masiviteti, të papare ndonjëherë në këtë qytet.

E gjithë kjo masë e madhe njerëzish e shoqruan kortezhin të varrezat e dëshmorëve, duke i rënë mes për mes bulevardit, nën tingujt e marshve funebër të orkestrës frymore të ushtrisë. Zbritja e arkivolit në shtratin e varrit, u shoqërua me të shtëna artilerie dhe pastaj me ekzekutimin e himnit të Flamurit e parakalimin e truporjes së nderit para varrit të tij të mbuluar me një mal kurora e buqetash me lule nga autoritetet dhe familjarët.

Shahin Toçi u varros përjetësisht përkrah shokëve të vet, dëshmor të Atdheut, duke shtuar edhe një emër tjetër lavdie në këto varreza.

Pas varrimit Bashkia e Burrelit organizoi një mbledhje solemne, kushtuar dëshmorit Shahin Toçi. Fjalën e rastit e mbajti kryetari i Bashkisë Skënder Lleshi. Folën në këtë ceremoni kryetarët e veteranëve të rrethit, përfaqësuesit i shtetit Italian dhe nipi i dëshmorit.

Mbledhja solemne u përcoll me një program shumë të pasur artistik, nga grupet artistike të Burrelit, të Mirditës e të Vlorës. Me entuziazëm e brohoritje të përsëritura e të papërkrahueshme u përcoll kënga polifonike e grupit të Vlorës, kushtuar dëshmorit Shahin Toçi.

Kështu i përjetëson populli ynë dëshmorët e Atdheut.

Organizata Kombëtare për Dëshmorët e Atdheut, u shprehë falenderime të veçanta nipërve të dëshmorit Shahin Toçi, Shahin Toçit të Ri dhe Osman Toçit, të dy djemtë e Islamit, vëlait të Shahinit, të cilët me përkushtim të rrallë, me shpenzime të mëdha, bënë të mundur gjetjen e varrit të Shahinit dhe mundësinë sjelljen e eshtrave të tij në Atdhe, duke organizuar me shpenzimet e tyre edhe këtë ceremoni madhështore.

Lum si ai, që le prapa brezni të tillë, siç ka lënë dëshmorin Shahin Toçi.

**Halii Katana-Bardhok Arapi**  
Rinas-Burrel, 25-26 mars 2011


## Rrethanat e vrasjes

Një vrasje e shëmtuar tronditi më 26 maj të vitit 1939 rrugën "Trastevere" në Romë. Një i ri shqiptar, me emrin Shahin Toçi, i sapodiplomuar në Akademinë Ushtarake, u gjend i vdekur nga autoritetet italiane. Shumë hipoteza do të hidheshin për shkakun e vdekjes, shumë pikëpyetje qëndronin rreth shkakut të saj, por e vërteta mbeti e pazbuluar. Shteti italian arkivoli dosjen Toçi, ndoshta për të fshehur atë që kishte ndodhur realisht e që kishte lidhje me aktin e madh patriotik të këtij shqiptari nga Mati.

Dy javë para se të gjendej i vrarë, Shahin Toçi kreu një gjest i cili, në distancën e 70 vjetëve, rrezaton patriotizëm dhe burrëri të spikatur. Eshitë pikërisht ai qëndrim i fortë prej shqiptari patriot, i cili ndoshta i kushtoi jetën, në mesin e një Italie të pushtuar nga ethet e fasismit dhe të dominuar nga këmishat e zeza. Megjithatë, para se të komentojmë vdekjen e tij, le të shohim cilin që dhe çfarë përfaqësonte ky djalos 21 vjeçar.

I lindur më 30 tetor 1918, Shahin do të shquhej shpejt për cilësitë e tij. Jeta e Shahin Toçit, peripecitë e studimeve në Itali dhe, përgjithësisht, ekzistenca e tij në pjesën e fundit të jetës, kanë qenë një dramë e vërtetë, e cila zhvillohej larg atdheut dhe që përfshinte dinamikën e ngjarjeve të trubullta për Shqipërinë, në vitin 1939...

Në debatet mes studentëve shqiptarë, veçanërisht të ndezura në ato momente, ai tregoi gjithnjë i



Shahin Islam Toçi (nipi)



Osman Islam Toçi (nipi)

kujdesëshëm, për të mos u lënë vend interpretimeve të lehta e sipërfaqësore. Ishte i bindur se mes propagandës fashiste dhe në një largësi aq të madhe nga vendi, ngjarjet, faktet dhe e vërteta e pushtimit vinin të shtrembëruara, emotive dhe subjektive. Megjithatë Shahini që ndër të parët që hodhën idenë e organizimit të studentëve për t'u kthyer në Shqipëri e për të luftuar për çlirimin e vendit. "Këta që flasin me fjalë të bukura dhe që e mbajnë vetëm të qytetëruar, në fakt justifikojnë robërinë e popujve", - shprehej ato ditë Shahin Toçi. "S'ka mbetur rrugë tjetër, veçse të hedhim armët dhe robën fashiste e të kthehemi në atdheun tonë. Atje s'ka humbur besa, as burrëria. Atje mund të organizohemi edhe më mirë, për të hedhur tujtë robërinë". Me këto fjalë në gojë, ai debatonte pa pushim me studentët e tjerë, të cilët u bindeshin pa shumë rezistencë ideve fashiste.

Shahin Toçi do të shihte gjithë dëshprim momentin kur kurora mbretrore shqiptare do të dorëzohet në Romë nga garda kombëtare, çka do të përjetohet nga ai si një tragjedi e brendshme. Megjithatë, Shahin Toçi diti të qëndrojë si një shqiptar i fortë edhe në ato ditë të vështira, edhe larg vendit të tij.

Me fillimin e majit 1939, studentët shqiptarë në Akademinë Ushtarake, i mbledhin në një sallë të madhe, për të bërë betimin. Komandanti i

Akademisë, si u foli studentëve për lidhjet e reja me Italisë dhe Shqipërisë, i ftoi ata që të bënin betimin fashist, ku angazhoheshin se do të ishin në shërbim të plotë të Romës. Sipas programit, betimi do të bëhej në një nga sheshet e kryeqytetit italian, në datën 13 maj 1939.

Ditën e betimit, në një ceremoni të blinduar nga trupat italiane, ku merrte pjesë dhe nënsekretari i luftës Pariani, studentit shqiptar Shahin Toçi u paraqit me një shirit të kuq e zi, mbi uniformën ushtarake italiane. Ky simbol krijoi pëshjellim të dukshëm te oficerët e lartë, që ishin prezent në ceremoni, të cilët i kërkuan të riut nga Shqipëria të hiqte menjëherë shirint kuq e zi. Ishte general Pariani, ai që u habit më shumë nga ky gjest: "Ç'vlerë ka kjo uniformë, mbreti juaj ka rënë", - iu drejtua ai Toçit. "Edhe mbretërit mund të bien, edhe uniformat mund të ndërrohen, por ky shirit mbetet"; iu përgjigj Shahin Toçi. Dëshmitarët e atij momenti tensioni thonë se gjeneralit Italian heshti pas replikës së të riut. Në të kundërt, studentëve shqiptarë iu kërkuua që të nesërmen të rreshtoheshin serish, për të recituar formulën e betimit fashist. Kur oficeri nisi të lexonte me zë të lartë tekstin, ajo që pasoi, ishte një heshtje e thellë. U kujtua se studentët nuk kuptonin shqip, por në atë çast Shahin Toçi doi nga rreshti dhe foli me zë të lartë: "Zoti gjeneral, ne jemi shqiptarë dhe